L I G J
Nr.8850, datë 27.12.2001

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË LUNDRIMIT DETAR" DHE NË "PROTOKOLLIN PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË PLATFORMAVE FIKSE, TË VENDOSURA NË SHELFIN KONTINENTAL"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar" dhe në "Protokollin për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së platformave fikse, të vendosura në Shelfin Kontinental" të 10 marsit 1988.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3211, datë 31.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTA
PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË LUNDRIMIT DETAR

Shtetet Palë në këtë Konventë:

- Duke pasur në mendje qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara lidhur me ruajtjen e paqes dhe sigurimin ndërkombëtar, nxitjen e marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimin midis Shteteve,
- Duke njohur në veçanti se çdo njeri ka të drejtën e jetës, lirisë dhe sigurisë së personit, siç parashikohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike,
- Thellësisht të shqetësuar për shkallëzimin e përbotshëm të akteve të terrorizmit në të gjitha format e tij, që rrezikojnë liritë themelore dhe dëmtojnë rëndë dinjitetin e qënieve njerëzore,
- Duke pasur parasysh se aktet e paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar rrezikojnë sigurinë e personave dhe pasurisë, ndikojnë shumë në funksionimin e shërbimeve detare dhe minojnë besimin e popujve të botës në sigurinë e lundrimit detar,
- Duke marrë në konsideratë se ndodhja e akteve të tilla përbën një çështje me shqetësim të madh për komunitetin ndërkombëtar në tërësi,
- Duke qenë të bindur për nevojën urgjente të zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar midis shteteve në hartimin dhe adaptimin e masave efikase dhe praktike për parandalimin e të gjitha akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar dhe ndjekjen ligjore dhe dënimin e shkaktarëve të tyre,
- Duke kujtuar Rezolutën 40/61 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të datës 9 dhjetor 1985, që ndër të tjera, "nxit të gjitha Shtetet në mënyrë të njëanshme dhe në bashkëpunim dhe me Shtete të tjera, si dhe me organet përkatëse të Kombeve të Bashkuara për të

kontribuar në eliminimin gradual të shkaqeve që mbështesin terrorizmin ndërkombëtar dhe për t'i kushtuar vëmendje të veçantë të gjitha situatave, duke përfshirë kolonializmin, racizmin dhe situata të tjera që shkaktojnë dhunimet në masë dhe flagrante të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe ato që shkakton pushtimi i huaj, të cilat mund të bëhen shkak për terrorizmin ndërkombëtar dhe mund të rrezikojnë paqen dhe njeriun ndërkombëtar",

- Duke kujtuar më tej se Rezoluta 40/61 "dënon në mënyrë të qartë si kriminale të gjitha aktet, metodat dhe praktikat e terrorizmit të kryera kudo dhe nga kushdo, përfshirë dhe ato që rrezikojnë marrëdhëniet midis Shteteve dhe sigurinë e tyre",

- Duke kujtuar gjithashtu se me Rezolutën 40/61 Organizata Detare Ndërkombëtare u ftua "të studiojë problemin e terrorizmit jashtë Shtetit ose kundër anijeve me synimin e dhënies së rekomandimeve për masat përkatëse",

- Duke patur në mendje Rezolutën A 584 (14) të datës 20 nëntor 1985, të Asamblesë të Organizatës Detare Ndërkombëtare, që bënte thirrje për shtimin e masave për të parandaluar aktet e paligjshme që kërcënojnë sigurinë e anijeve dhe sigurinë e pasagjerëve dhe ekuipazheve të tyre,

- Duke parë se aktet e ekuipazheve, të cilat i nënshtrohen disiplinës normale në bordin e anijes, janë jashtë fushës së veprimit të kësaj Konvente,

- Duke afirmuar dëshirën për rregullat dhe standardet e monitorimit që lidhen me parandalimin dhe kontrollin e akteve të paligjshme kundër anijeve dhe personave në bordin e anijeve, me qëllimin e azhornimit të tyre si të nevojshme dhe në këtë kuptim i kushton vëmendje masave për parandalimin e akteve të paligjshme kundër pasagjerëve dhe ekuipazheve në bordin e anijeve, të rekomanduara nga Komuniteti i Sigurisë Detare të Organizatës Detare Ndërkombëtare,

- Duke afirmuar më tej se çështjet që nuk rregullohen me anë të kësaj Konvente vazhdojnë të rregullohen nga normat dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme,

- Duke njohur (ditur) nevojën e të gjitha Shteteve, në luftimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar për të përmbushur me përpikmëri rregullat dhe parimet e ligjit ndërkombëtar të përgjithshëm,

Neni 1

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Për qëllimet e kësaj Konvente, "anije" nënkupton një anije të çfarëdo tipi qoftë, që nuk ndodhet në mënyrë të përhershme (përgjithmonë) në fundin e detit, që përfshin mjetet e lehta të lundrimit të mbështetura në mënyrë dinamike, mjetet zhytëse ose ndonjë mjet tjetër lundrimi.

Neni 2

1. Kjo Konventë nuk zbatohet për:

a) një anije lufte; ose

b) një anije që zotërohet ose drejtohet nga një Shtet, kur përdoret si mjet ndihmës detar ose për qëllime doganore ose policore; ose

c) një anije që është tërhequr nga lundrimi ose e vendosur nën ruajtje.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk ndikon në imunitetet e anijeve të luftës dhe anijeve të tjera qeveritare që përdoren për qëllime jokomerciale.

Neni 3

1. Çdo person kryen një shkelje nëse, në mënyrë të paligjshme dhe me qëllim:

a) kap ose ushtron kontroll mbi një anije me anën e forcës ose të kërcënimit të saj ose ndonjë forme tjetër kërcënimi; ose

b) kryen një akt dhune kundër një personi në bordin e një anijeje, duke rrezikuar lundrimin e sigurtë të asaj anijeje; ose

c) shkatërron një anije ose shkakton dëmtim të një anijeje ose të ngarkesës së saj, duke rrezikuar lundrimin e sigurtë të asaj anijeje; ose

d) vendos ose nxit që të vendoset në një anije, me anë të çfarëdo mjeti, një pajisje ose substancë, e cila mund ta shkatërrojë anijen ose t'i shkaktojë dëmtime asaj anijeje ose ngarkesës së saj,

që rrezikojnë ose mund të rrezikojnë lundrimin e sigurtë të asaj anijeje; ose

e) shkatërron ose dëmton rëndë lehtësirat e lundrimit detar ose ndërhyn seriozisht në funksionimin e tyre, në qoftë se ndonjë akt i tillë mund të rrezikojë lundrimin e sigurtë të një anijeje; ose

f) jep informacion të cilin ai e di që është jo i vërtetë duke rrezikuar si rrjedhim lundrimin e sigurtë të një anijeje ose;

g) plagos ose vret ndonjë person për të kryer ose për të tentuar të kryejë ndonjërën prej shkeljeve të përcaktuara në nënparagrafet nga (a) deri tek (f).

2. Çdo person kryen gjithashtu një shkelje nëse:

a) tenton të kryejë ndonjë nga shkeljet e përcaktuara në paragrafin 1; ose

b) ka lidhje me kryerjen e ndonjërës prej shkeljeve të përcaktuara në paragrafin 1 të kryera nga ndonjë person ose është ndryshe bashkëpunëtor i një personi që kryen një shkelje të tillë; ose

c) kërcënon me, ose pa kusht, siç parashikohet në normat e së drejtës ndërkombëtare, me synim detyrimin e një personi fizik ose juridik për të kryer ose për të moskryer një akt të caktuar; për të kryer ndonjë nga shkeljet e përcaktuara në paragrafin 1 nënparagrafet (b), (c) dhe (e) në qoftë se ai kërcënim mund të rrezikojë lundrimin e sigurtë të anijes në fjalë.

Neni 4

1. Kjo Konventë zbatohet nëse anija po lundron ose është programuar të lundrojë në, midis ose nga ujërat përtej limitit të jashtëm të ujërave të detit territorial të një Shteti të vetëm, ose kufijtë ndarës të detit të tij territorial me Shtetet fqinjë.

Në rastet kur kjo Konventë nuk vepron sipas paragrafit 1, ajo, sidoqoftë, vepron kur cenuesi ose tentatori gjendet në territorin e një Shteti Palë tjetër nga Shteti të cilit i referohet paragrafi 1.

Neni 5

Çdo Shtet Palë duhet t'i bëjë shkeljet e parashikuara në nenin 3 të dënueshme, duke parashikuar dënime të përshtatshme, të cilat duhet të kenë parasysh natyrën e rëndë të këtyre shkeljeve.

Neni 6

1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi shkeljet e përcaktuara në nenin 3 kur shkelja kryhet:

a) kundër ose në bordin e një anijeje që mban flamurin e Shtetit në kohën që kryhet shkelja; ose

b) në territorin e atij Shteti, që përfshin dhe ujërat e tij territoriale; ose

c) nga një shtetas i atij Shteti.

2. Një Shtet Palë mund të vendosë gjithashtu juridiksionin e tij mbi ndonjë shkelje të tillë kur:

a) ajo kryhet nga një person pa shtetësi, rezidenca e përhershme e të cilit është në atë Shtet; ose

b) gjatë kryerjes së tij kapet, kërcënohet, plagoset ose vritet një shtetas i atij Shteti; ose

c) ai kryhet në një përpjekje për ta detyruar atë Shtet të kryejë ose të abstenojë në kryerjen e ndonjë akti.

3. Çdo Shtet Palë, që ka vendosur juridiksionin e përmendur në paragrafin 2, duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës Ndërkombëtare Detare (këtu i referuar më pas si Sekretari i Përgjithshëm).

Në qoftë se më vonë një Shtet i tillë Palë e anulon atë juridiksion, ai duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm.

4. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi shkeljet e përcaktuara në nenin 3, në rastet ku shkelësi i pretenduar është i pranishëm në territoin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë në ndonjë nga Shtetet Palë, që kanë vendosur juridiksionin e tyre në përputhje me paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 7

1. Duke qenë të bindur se rrethanat janë të përmbushura, çdo Shtet Palë, në territorin e të cilit shkelësi ose shkelësi i pretenduar është i pranishëm, duhet, në përputhje me ligjin e tij, ta mbajë nën arrest ose të marrë masa të tjera për të siguruar praninë e tij për një kohë të tillë që është e nevojshme për të bërë të mundur ndërhyrjen në çdo proces gjykimi ose ekstradimi.

2. Një Shtet i tillë duhet, menjëherë, të bëjë një hetim paraprak mbi faktet në përputhje me legjislacionin e tij.

3. Çdo person, lidhur me të cilin merren masat e shpjeguara në paragrafin f, duhet t'i jepet e drejta:

a) të komunikojë pa vonesë me përfaqësuesin përkatës më të afërt të Shtetit i të cilit ai është shtetas ose që ndryshe ka të drejtën të vendosë një komunikim të tillë ose në qoftë se ai është person pa shtetësi, Shtetin në territorin e të cilit ai ka rezidencën e tij të zakonshme;

b) të vizitohet nga një përfaqësues i atij Shteti.

4. Të drejtat e parashikuara në paragrafin 3 duhet të ushtrohen në përputhje me ligjet dhe rregullat e Shtetit në territorin e të cilit shkelësi ose shkelësi i pretenduar është i pranishëm; sipas klauzolës së ligjit dhe rregullat në fjalë duhet të bëjnë të mundur veprimin e plotë të qëllimeve, për të cilat janë synuar të drejtat e akorduara sipas paragrafit 3.

5. Kur një Shtet Palë, në përputhje me këtë nen, ka vendosur një person nën arrest, ai duhet të njoftojë menjëherë shtetet, që kanë vendosur juridiksionin sipas nenit 6 paragrafi 1, dhe në qoftë se ai e konsideron atë të këshillueshme, ndonjë Shtet tjetër të interesuar për faktin që një person i tillë është nën arrest dhe për rrethanat që garantojnë ndalimin e tij. Shteti që bën hetimin paraprak të shpjeguar në paragrafin 2 të këtij neni duhet t'i njoftojë menjëherë rezultatet e tija Shteteve në fjalë dhe duhet të tregojë nëse ai synon të ushtrojë juridiksionin e tij.

Neni 8

1. Kapiteni i një anijeje të një Shteti Palë ("Shteti i flamurit") mund t'ia dorëzojë autoriteteve të ndonjë Shteti Palë ("Shteti marrës") ndonjë person për të cilin ai ka shkaqe të arsyeshme të besojë se ka kryer një nga shkeljet e përcaktuara në nenin 3.

2. Shteti flamur duhet të sigurojë se kapiteni i anijes së tij është i detyruar, kudo që është e praktikueshme dhe në qoftë se është e mundur para hyrjes në ujërat territoriale të Shtetit marrës, se ka në bord ndonjë person të cilin synon ta dorëzojë në përputhje me paragrafin 1, t'i japë njoftim autoriteteve të Shtetit marrës për synimin e dorëzimit të një personi të tillë dhe arsyet për këtë.

3. Shteti marrës duhet të pranojë dorëzimin, përveç rastve ku ka arsye të mendojë se Konventa nuk është e zbatueshme për aktet që shkaktojnë dorëzimin dhe duhet të procedojë në përputhje me klauzolat e nenit 7.

Çdo refuzim për të pranuar një dorëzim duhet të shoqërohet me një deklaratë për arsyet e refuzimit.

4. Shteti flamur duhet të sigurojë se kapiteni i anijes së tij është i detyruar të sigurojë autoriteteve të Shtetit marrës faktet nën zotërimin e kapitenit që lidhet me shkeljen e pretenduar.

5. Një Shtet marrës, që ka pranuar dorëzimin e një personi sipas paragrafit 3, mund, sipas radhës, t'i kërkojë Shtetit flamur se duhet të marrë në konsideratë ndonjë kërkesë të tillë dhe, në qoftë se ai pranon kërkesën, ai duhet të procedojë sipas nenit 7. Në qoftë se Shteti flamur refuzon një kërkesë, ai duhet t'i japë Shtetit marrës një deklaratë me arsyet për këtë.

Neni 9

Asgjë në këtë Konventë nuk duhet të ndikojë në ndonjë farë mënyre në rregullat që lidhen me kompetencën e Shteteve për të ushtruar juridiksionin e hetimit ose të detyrimit në bordin e anijeve që nuk kanë flamurin e tyre.

Neni 10

1. Shteti Palë, në territorin e të cilit gjendet shkelësi ose ai që ka tentuar, duhet, në rastet në të

cilat zbatohet neni 6 në qoftë se ai nuk e ekstradon atë, të detyrohet pa përjashtim cilido qoftë ai, pavarësisht nëse shkelja është kryer në territorin e tij ose jo, t'ia dorëzojë rastin pa vonesë autoriteteve të tij kompetente për qëllim procedimi sipas ligjeve të atij Shteti. Këto autoritete duhet të marrin vendimin e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e ndonjë shkeljeje tjetër të natyrës së rëndë, sipas ligjeve të atij Shteti.

2. Çdo personi, lidhur me të cilin po kryhen procedurat në lidhje me ndonjë nga shkeljet e përcaktuara në nenin 3, duhet t'i garantohet trajtimi i drejtë në të gjitha fazat e procedurave, përfshirë gëzimin e të gjitha të drejtave dhe garancive për procedura të tilla me anë të ligjit të Shtetit në territorin e të cilit ai është i pranishëm.

Neni 11

1. Shkeljet e përcaktuara në nenin 3 duhet të përcaktohen për t'i përfshirë si shkelje të ekstradueshme në ndonjë traktat ekstradimi që ekziston midis ndonjërit prej Shteteve Palë. Shtetet Palë marrin përsipër të përfshijnë shkelje të tilla si shkelje të ekstradueshme në çdo traktat për të përfunduar midis tyre.

2. Në qoftë se një Shtet Palë, që bën ekstradimin e kushtëzuar bazuar në ekzistencën e një traktati, merr një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë, me të cilin nuk ka asnjë traktat ekstradimi, duhet të konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradim lidhur me shkeljet e përcaktuara në nenin 3. Ekstradimi duhet t'i nënshtrohet kushteve të tjera që jepen nga ligji i Shtetit Palë të lutur.

3. Shtetet Palë, që nuk e bëjnë ekstradimin të kushtëzuar me ekzistencën e një traktati, duhet të njohin shkeljet e përcaktuara në nenin 3 si shkelje të ekstradueshme midis tyre, sipas kushteve të dhëna nga ligji i Shtetit të lutur (kërkues).

4. Në qoftë se është e nevojshme, shkeljet e përcaktuara në nenin 3 duhet të trajtohen për qëllimet e ekstradimit midis Shteteve Palë sikur ato janë kryer jo vetëm në vendin në të cilin ato ndodhen, por gjithashtu edhe në një vend brenda juridiksionit të Shtetit Palë që kërkon ekstradimi.

5. Një Shtet Palë, që merr më shumë se një kërkesë për ekstradim nga Shtetet që kanë vendosur juridiksionin sipas nenit 7 dhe që vendos të mos e ndjekë penalisht, duhet, në zgjedhjen e Shtetit në të cilin shkelësi ose shkelësi i pretenduar do të ekstradohet, t'i kushtojë vëmendjen e duhur interesave dhe përgjegjësive të Shtetit Palë, flamurin e së cilës ka anija në kohën e kryerjes së shkeljes.

6. Në marrjen parasysh të kërkesave për ekstradim të një shkelësi të pretenduar në përputhje me këtë Konventë, Shteti i lutur duhet t'i ushtojë vëmendjen e duhur nëse të drejtat e tij mund të plotësohen në Shtetin kërkues, ashtu siç përcaktohen në nenin 7 paragrafi 3.

7. Lidhur me shkeljet që janë përcaktuar në këtë Konventë, klauzola e të gjitha traktateve të ekstradimit dhe rregullimet të aplikueshme midis Shteteve janë modifikuar midis Shteteve Palë deri në masën që ato janë të papajtueshme me këtë Konventë.

Neni 12

1. Shtetet Palë duhet t'i japin njëri-tjetrit masën më të madhe të asistencës lidhur me proceset kriminale të sjella për shkeljet e përcaktuara në nenin 3, duke përfshirë dhe asistencën për marrjen e provave (fakteve) në dispozicion të tyre të nevojshme.

2. Shtetet Palë duhet të zbatojnë detyrimet e tyre sipas paragrafit 1 në përputhje me ndonjë traktat për asistencën e ndërsjellë që mund të ekzistojnë midis tyre. Në mungesë të traktateve të tilla, Shtetet Palë duhet t'i japin njëri-tjetrit asistencën në përputhje me ligjin e tyre ndërkombëtar.

Neni 13

1. Shtetet Palë duhet të bashkëpunojnë në parandalimin e shkeljeve të parashikuara në nenin 3, veçanërisht duke:

(a) marrë të gjitha masat praktike për të parandaluar në territoret e tyre respektive përgatitjet për kryerjen e këtyre akteve, brenda ose jashtë territorit të tyre;

(b) shkëmbyer informata në përputhje me të drejtën e tyre të brendshme dhe koordimin e masave administrative dhe të tjera, që duhet të merren për parandalimin e shkeljeve të parashikuara në

nenin 3.

2. Kur, për shkak të kryerjes së ndonjë shkeljeje të parashikuar në nenin 3, kalimi i një anijeje është vonuar ose ndërprerë, çdo Palë, në territorin e të cilit anija, pasagjerët, ose ekuipazhi janë të pranishëm, duhet të sigurohet, për të ushtruar të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur ndalimin ose vonesën e padrejtë të anijes, pasagjerëve ose ekuipazhit të saj.

Neni 14

Çdo Shtet Palë, që ka arsye të besojë se një shkelje e përcaktuar në nenin 3 do të kryhet, duhet, në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm, të japë sa më shpejt që të jetë e mundur ndonjë informacion të përshtatshëm në dispozicion të tij atyre Shteteve që ai beson se do të jenë Shtetet që kanë vendosur juridiksionin e tyre në përputhje me nenin 6.

Neni 15

1. Çdo Shtet Palë duhet, në përputhje me ligjin e tij kombëtar, t'i japë Sekretarit të Përgjithshëm sa më shpejt të jetë e mundur ndonjë informacion të duhur lidhur me:

a) rrethanat e shkeljet;

b) veprimin e ndërmarrë sipas neni 13 paragrafi 2;

c) masat e marra në lidhje me shkelësin ose shkelësin e pretenduar dhe në veçanti për rregullat e ndonjë procedure ekstradimi ose procedura të tjera ligjore.

2. Çdo Shtet Palë, ku shkelësi i pretenduar ndiqet penalisht, duhet, në përputhje me ligjin e tij kombëtar, t'i komunikojë rezultatin përfundimtar të procesit të gjykimit Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Informacioni i dhënë në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 duhet t'i komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm të gjitha Shteteve Palë anëtarëve të organizatës Ndërkombëtare Detare (këtu e referuar më pas "si Organizata"), Shteteve të tjera të interesuara dhe organizatave ndërqeveritare përkatëse.

Neni 16

1. Çdo mosmarrëveshje midis dy ose më shumë Shteteve Palë, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente që nuk mund të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve brenda një kohe të arsyeshme, duhet, me kërkesën e njërës prej tyre, të dërgohet në arbitrazh. Në qoftë se brenda 6 muajve nga data e kërkesës për arbitrazh, Palët nuk janë në gjendje të bien dakord për organizimin e arbitrazhit çdonjëra prej këtyre palëve mund ta dërgojë mosmarrëveshjen në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesë në përputhje me Statutin e Gjykatës.

2. Çdo Shtet Palë në kohën e nënshkrimit ose ratifikimit, pranimit ose miratimit të kësaj Konvente ose të aksesit në të duhet të deklarojë se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga ndonjë ose të gjitha klauzolat e paragrafit 1. Shtetet e tjera Palë nuk do të detyrohen nga këto klauzola në lidhje me ndonjë Shtet Palë që ka bërë një rezervim të tillë.

3. Çdo Shtet Palë që ka bërë një rezervim të tillë në përputhje me paragrafin 2 mund ta tërheqë atë rezervim në çdo kohë me anë të njoftimit për Sekretarin e Përgjithshëm.

Neni 17

1. Konventa do të jetë e hapur për nënshkrim në Romë më 10 mars 1988 nga Shtetet që marrin pjesë në Konferencën Ndërkombëtare mbi ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detare dhe në selinë e Organizatës nga Shtetet që prej datës 9 mars 1988 deri më 9 mars 1989. Më vonë ajo do të mbetet e hapur për aderim.

2. Shtetet mund të shprehin miratimin e tyre për t'u detyruar nga kjo Konventë me anë të:

a) nënshkrimit pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose miratimin; ose

b) nënshkrimit që i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit i pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

c) aksesit.

Neni 18

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës në të cilën 15 Shtete ose e kanë nënshkruar atë pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose miratimin, ose kanë depozituar një instrument të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aksesit në lidhje me të.

2. Për një Shtet që depoziton një instrument të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aksesit lidhur me këtë Konventë pasi të jenë përmbushur kushtet për hyrjen në fuqi të saj, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aksesi do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës të një depozitimi të tillë.

Neni 19

1. Kjo Konventë mund të denoncohet nga çdo Shtet Palë në çdo kohë pas kalimit të një viti nga data në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi për atë Shtet.

2. Denoncimi duhet të bëhet me anë të depozitimit të një instrumenti denoncimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Një denoncim duhet të hyjë në fuqi pas një viti ose në një periudhë më të gjatë kohe, siç mund të përcaktohet në instrumentin e denoncimit mbas marrjes së tij nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 20

1. Një konferencë me qëllimin e rishikimit ose ndryshimit të kësaj Konvente mund të thirret nga Organizata.

2. Sekretari i Përgjithshëm duhet të thërrasë një konferencë të Shteteve Palë të kësaj Konvente, për rishikimin ose ndryshimin e saj (Konventes), me kërkesën e një të tretës të Shteteve Palë, ose dhjetë Shtete Palë, cilado qoftë shifra më e madhe.

3. Çdo instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aksesi i depozituar pas datës së hyrjes në fuqi të një ndryshimi në këtë Konventë duhet të vlerësohet (gjykohet) për t'u zbatuar në këtë Konventë si i ndryshuar.

Neni 21

1. Kjo Konventë do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm duhet:

a) të informojë të gjitha Shtetet që e kanë nënshkruar këtë Konventë ose kanë rënë dakord për atë dhe të gjithë anëtarët e Organizatës për:

i) çdo nënshkrim të ri ose depozitim, ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aksesi, së bashku me datën e tij;

ii) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente;

iii) depozitimin e ndonjë instrumenti denoncimi të kësaj Konvente, së bashku me datën në të cilën ai është marrë dhe datën në të cilin denoncimi hyn në fuqi;

iv) marrjen e ndonjë deklarate ose njoftimi të bërë sipas kësaj Konvente;

b) për dërgimin e kopjeve të vërteta (origjinale) të vërtetuara të kësaj Konvente të gjitha Shteteve që kanë nënshkruar këtë Konventë ose kanë rënë dakord për atë.

3. Menjëherë pasi kjo Konventë hyn në fuqi, një kopje (kopje e vëretetë origjinale) e vërtetuar e saj duhet t'i dërgohet nga vendi depozitues Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrimin dhe botim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 22

Kjo Konventë është hartuar në një origjinal të vetëm në gjuhët arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle, duke qenë secili tekst njëlloj autentik.

Duke qenë dëshmitare, nënshkruesit të autorizuar në kohën e duhur nga Qeveritë e tyre respektive për atë qëllim e kanë nënshkruar këtë Konventë.

Hartuar në Romë, në këtë ditë të dhjetë të marsit njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë. Kopja e vërtetë (origjinale) e (i) vërtetuar në gjuhët anglisht, frëngjisht, dhe spanjisht të Konventës mbi Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, hartuar në Romë më 10 mars 1988, origjinali i së cilës depozitohet prej Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës Ndërkombëtare Detare.

Për Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës Ndërkombëtare Detare.

PROTOKOLL

PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË PLATFORMAVE FIKSE TË VENDOSURA NË SHELFIN KONTINENTAL

Shtetet Palë të këtij Protokolli,

Duke qenë Palë të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar,

Duke njohur arsyet për të cilat Konventa u hartua, e cila zbatohet gjithashtu për platformat fikse në Shelfin Kontinental,

Duke marrë parasysh dispozitat e kësaj Konvente,

Duke afirmuar se çështjet që nuk rregullohen nga ky Protokoll vazhdojnë të rregullohen nga rregullat dhe parimet e së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Dispozitat e neneve 5 dhe 7, si dhe të neneve nga 10 deri në 16 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar (këtu më pas referuar si "Konventa") do të zbatohen gjithashtu mutatis mutandis për shkeljet e përcaktuara në nenin 2 të këtij Protokolli kur shkelje të tilla janë kryer në bord ose kundër platformave fikse të vendosura në Shelfin Kontinental.

2. Në rastet kur ky Protokoll nuk zbatohet në përputhje me paragrafin 1, ai sidoqoftë zbatohet kur shkelësi ose shkelësi i pretenduar ndodhet në territorin e një Shteti Palë, të ndryshëm nga Shteti në ujërat e brendshme ose ujërat territoriale të të cilit platforma fikse është vendosur.

3. Për qëllime të këtij Protokolli, "platformë fikse" nënkupton një ishull artificial, instalim ose strukturë, e vendosur në mënyrë të përhershme në shtratin e detit për qëllime eksplorimi ose shfrytëzimi të burimeve ose për qëllime të tjera ekonomike.

Neni 2

1. Një person kryen një shkelje nëse ai person në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme:

a) kap ose ushtron kontroll mbi një platformë fikse me anë të forcës ose kërcënimit për përdorimin e saj ose ndonjë forme tjetër kërcënimi; ose

b) kryen një akt dhune kundër një personi në bordin e një platforme fikse, në qoftë se ai akt mund të rrezikojë sigurinë e saj; ose

c) shkatërron një platformë fikse ose i shkakton dëme asaj që mund të rrezikojnë sigurinë e saj; ose

d) vendos ose shkakton vendosjen në një platformë fikse, me anë të çfarëdo mjeti, qoftë ai një pajisje ose një substanë që mund të shkatërrojë atë platformë fikse ose mund të rrezikojë sigurinë e saj; ose

e) dëmton ose vret ndonjë person, gjatë kryerjes ose tentativës për kryerjen e ndonjë prej shkeljeve të përcaktuara në nënparagrafët që nga (a) deri tek (d).

2. Një person kryen gjithashtu një shkelje në qoftë se ai person:

a) përpiqet të kryejë ndonjë nga shkeljet e përcaktuara në paragrafin 1; ose

b) është bashkëfajtor në kryerjen e ndonjë prej shkeljeve të tilla të kryera nga çdo person ose në një mënyrë tjetër është bashkëpunëtor i një personi që kryen ndonjë shkelje të tillë; ose

c) kërcënon, me kushte ose pa kusht, ashtu si parashikohet sipas së drejtës kombëtare, me synim detyrimin e një personi fizik ose juridik të kryejë ose të pengojë kryerjen e ndonjë veprimi, të kryejë ndonjë nga aktet e përcaktuara në paragrafin 1, nënparagrafët (b) dhe (c) , nëse ai kërcënim mund të rrezikojë sigurinë e platformës fikse.

Neni 3

1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi shkeljet e përcaktuara në nenin 2 kur shkelja kryhet:

a) kundër ose në bordin e një platforme fikse kur ajo është e vendosur në Shelfin Kontinental të atij Shteti; ose

b) nga një shtetas i atij Shteti.

2. Një Shtet Palë mund të vendosë, gjithashtu, juridiksionin e tij mbi ndonjë shkelje të tillë kur:

a) shkelja kryhet nga një person pa shtetësi, vendbanimi i zakonshëm i të cilit është në atë Shtet.

b) gjatë kryerjes së kësaj shkeljeje kapet, kërcënohet, plagoset ose vritet një shtetas i atij Shteti; ose

c) shkelja kryhet në një përpjekje për të detyruar atë Shtet të kryejë ose të pengojë kryerjen e ndonjë veprimi.

3. Çdo Shtet Palë që ka vendosur juridiksionin e përmendur në paragrafin 2 duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës Ndërkombëtare Detare. (Këtu më pas i referuar si Sekretari i Përgjithshëm). Në qoftë se ky Shtet Palë më vonë e heq atë juridiksion, ai duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm.

4. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi shkeljet e përcaktuara në nenin 2, në rastet ku shkelësi i pretenduar është i pranishëm në territorin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë në ndonjë nga Shtetet Palë që kanë vendosur juridiksionin e tyre në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

5. Ky Protokoll nuk përjashton ndonjë juridiksion penal të ushtruar në përputhje me të drejtën kombëtare.

Neni 4

Asgjë në këtë Protokoll nuk do të ndikojë në ndonjë mënyrë në rregullat e së drejtës ndërkombëtare, në lidhje me platformat fikse të vendosura në Shelfin Kontinental.

Neni 5

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim, në Romë në 10 mars 1988 dhe në Selinë e Organizatës Ndërkombëtare Detare (kështu më pas e referuar si "Organizata") nga 14 mars 1988 deri më 9 mars 1989 nga çdo Shtet që ka nënshkruar Konventën. Ai më pas do të mbetet i hapur për aderim.

2. Shtetet mund të shprehin pëlqimin e tyre për të qenë të detyruar nga ky Protokoll me anë të:

a) nënshkrimit pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin; ose

b) nënshkrimin, e kushtëzuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi, i ndjekur nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

c) aderimit.

3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi do të kryhet me anë të depozitimit të një instrumenti për këtë qëllim pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

4. Vetëm një Shtet, i cili ka nënshkruar Konventën pa rezerva në lidhje me ratifikimin, pranimin ose miratimin, ose ka ratifikuar, pranuar, miratuar ose ka aderuar në këtë Konventë mund të bëhet Palë në këtë Protokoll.

Neni 6

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë mbas datës në të cilën tre Shtete ose e kanë nënshkruar atë pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose miratimin, ose kanë depozituar një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi në lidhje me të. Megjithatë ky Protokoll nuk do të hyjë në fuqi para se Konventa të ketë hyrë në fuqi.

2. Për një Shtet që depoziton një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi në lidhje me këtë Protokoll pasi kushtet për hyrjen në fuqi janë plotësuar, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi do të hyjnë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës së këtij depozitimi.

Neni 7

1. Ky Protokoll mund të denoncohet nga çdo Shtet Palë në çdo kohë, pas kalimit të një viti nga data në të cilën ky Protokoll hyn në fuqi për atë Shtet.

2. Denoncimi do të bëhet me anë të depozitimit të një instrumenti denoncimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Një denoncim do të hyjë në fuqi pas një viti ose në një periudhë më të gjatë kohe, siç mund të përcaktohet në instrumentin e denoncimit, pas marrjes të instrumentit të denoncimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

4. Një denoncim i Konventës nga një Shtet Palë do të konsiderohet të jetë denoncim i këtij Protokolli nga ajo Palë.

Neni 8

1. Një konferencë me qëllimin e rishikimit ose ndryshimit të këtij Protokolli mund të thirret nga Organizata.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të thërrasë një konferencë të Shteteve Palë në këtë Protokoll, për rishikimin ose ndryshimin e tij, me kërkesën e një të tretës të Shteteve Palë ose pesë shteteve Palë, cilado qoftë shifra më e madhe.

3. Çdo instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i depozituar pas datës së hyrjes në fuqi të një ndryshimi në këtë Protokoll do të konsiderohet se zbatohet ndaj këtij Protokolli të ndryshuar.

Neni 9

1. Ky Protokoll do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm:

a) do të informojë të gjitha Shtetet që kanë nënshkruar këtë protokoll ose kanë aderuar në të, si dhe të gjithë Anëtarët e Organizatës për:

I) çdo nënshkrim të ri ose depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi së bashku me datën e tij;

II) datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli;

III) depozitimin e çdo instrumenti denoncimi të këtij Protokolli, së bashku me datën në të cilën ai është marrë dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi;

IV) marrjen e çdo deklarate ose njoftimi të bërë sipas këtij Protokolli ose sipas Konventës, në lidhje me këtë Protokoll;

b) i dërgon kopjet origjinale të vërtetuara të këtij Protokolli të gjitha Shteteve që e kanë nënshkruar këtë Protokoll ose kanë aderuar në të.

3. Në momentin që ky Protokoll hyn në fuqi, një kopje e vërtetuar e tij duhet t'i dërgohet nga depozituesi Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe botim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 10

Ky Protokoll është bërë në një origjinal të vetëm në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse

dhe spanjolle, secili prej teksteve njëlloj autentik.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar në mënyrën e duhur nga qeveritë e tyre përkatëse për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Romë, më 10 mars 1988.

Kopje të certifikuar në anglisht, frëngjisht dhe spanjisht të Protokollit mbi shtyrjen e akteve të paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental, bërë në Romë më 10 mars 1988, origjinali i të cilit është depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës Ndërkombëtare Detare.

Për Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës Ndërkombëtare Detare.